P.nr.922/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit H. Th., nga fshati N., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3754/15 të datës 03.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në pranin e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me datë 09.02.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H. TH. , nga i ati Q., dhe nënës D. e lindur T., i lindur me datë *data e lindejs*... në fshatin N., Komuna e Prizrenit, ku edhe jeton, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, bujk, i martuar, baba i tetë fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.2 të KPP-ës.

REFUZOHET AKUZA

Se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 08.08.2015, në fshatin N., - Komuna e Prizrenit, pikërisht në shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë që pllombat shtetërore i ka të manipuluara, në brendi numri i njehsorit është i manipuluar ku ka gjurmë të gërvishtjes në numërator, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç rast ndërmarrjes së dëmtuar ,,KEDS,, Departamenti ligjor ne Prizren, i ka shkaktuar dëm material,

Këso dore do të kishte kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të te KP-ës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3754/2015 të datës 03.05.2016, kundër të akuzuarit H. Th., nga fshati N., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 09.02.2017, i akuzuari H. Th. ka parashtruar gjykatës aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.2149/2015 të datës 25.10.2016, i cili aktgjykim është i plotfuqishëm me datën 07.12.2016, nga i cili aktgjykim vërtetohet që për të njëjtën vepër penale,

dhe ate në kohë dhe vend të njëjtë të kryer, sipas kësaj aktakuze PP.nr.3754/2015 të datës 03.05.2016, i njëjti është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.922/2016 me datë 09.02.2017

Procesmbajtësja **Gjyqtari**
Naxhis Sharani **Luan Berisha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.